



REPUBLIKAE KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRIŠTINA – BASIC COURT OF PRISTINA

GJ.A.nr. 439/22

Datë: 19.05.2022

Në bazë të nenit 14 të Ligjit për Gjykata (Ligji nr.06/L-054) dhe Rregullores Nr.02/2020 Për organizmin dhe veprimtarinë e brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës, e bazuar në vendimin KGJK.nr.288/2021 të datës 18.10.2021, Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, i propozon Këshillit Gjyqësorë të Kosovës, për miratim:

**NDRYSHIMIN E PLANIT TË PUNËS SË GJYQTARËVE DHE ADMINISTRATES SË
GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË PËR VITIN 2022**

Caktimin e gjyqtarit Latif Xhemajli nga Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil në Departamentin Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Caktimin e gjyqtarit Ramush Bardiqi nga Departamenti Administrativ – Divizioni Fiskal në Departamentin Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Caktimin e gjyqtarit Adnan Konushevci - Udhëheqës i Departamentit të Përgjithshëm dhe Gjyqtar përgjegjës i Divizionit Civil.

A r s y e t i m

Kryetarja e gjykatës, pas diskutimit në kolegjiun dhe aprovimit njëzëri nga gjyqtarët, i propozon Këshillit Gjyqësor të Kosovës të miratoj ndryshimin e Planit të punës për vitin 2022 për Gjykatën Themelore në Prishtinë, në atë mënyrë që gjyqtari Latif Xhemajli të caktohet nga Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil në Departamentin Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë, si dhe të miratoj propozimin për caktimin gjyqtarit Adnan Konushevci udhëheqës të Departamentit të Përgjithshëm si dhe gjyqtar mbikëqyrës i Divizionit Civil.

Po ashtu, pas krijimit të Gjykatës Komerciale dhe kalimit të lëndëve nga Divizioni Fiskal në këtë gjykatë, është paraqit nevoja për sistemim të gjyqtarit Ramush Bardiqi në një pozite tjetër, pasi që i njëjti deri me tani ka qenë gjyqtar në Divizionin Fiskal.


Duke parë nevojat e Departamentit Administrativ dhe ngarkesës me lëndë si dhe përvojës që ka gjyqtari Bardiqi në lëmin administrative, propozojmë që ky gjyqtar të sistemohet në Departamentin Administrativ.

Propozimi për ndryshim të planit të punës – caktimi i gjyqtarëve në fjalë, është i bazuar në kualifikimet e tyre si gjyqtar dhe se vlerësojmë se me këto ricaktime do të rritet efikasiteti i punës së gjykatës.

Pjesa tjetër e planit të punës, mbetet e pandryshuar.

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë

Albina Shabani – Rama





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRIŠTINA – BASIC COURT OF PRISTINA

GJ.A.nr.441/2022

KRYETARJA E GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË, Albina Shabani-Rama, në bazë të nenit 32 të Ligjit për Gjykatat (Ligji nr.06/L-054) dhe nenit 11 par. 3 të Rregullores Nr.02/2020, Për Organizmin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës, me datë 19.05.2022, merr këtë:

V E N D I M

- I. Gjyqtari i Gjykatës Themelore në Prishtinë Latif Xhemajli, **CAKTOHET** nga Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil në Departamentin Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi nga data 01.06.2022.

A r s y e t i m

Pas mbajtjes së kolegjiut me datë 18.05.2022 me gjyqtarët e Departamentit të Përgjithshëm – Divizioni Civil dhe aprovimit njëzëri, me qëllim të plotësimit të pozitave vakante për shkak të avancimit të gjyqtarëve të Departamentit Administrativ në Gjykatën e Apelit, Kryetarja e Gjykatës ka vendosur që të caktoj gjyqtarin Latif Xhemajli nga Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil në Departamentin Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke u bazuar në kualifikimet e tij të cilat parashihen me nenin 32 të Ligjit për Gjykatat, si dhe për të siguruar një menaxhim dhe gjykim më efikas të lëndëve sipas nenit 11 par. 3 të Rregullores Nr.02/2020.


Vendimi është mbështetur në nenin 32 të Ligjit për Gjykata, Nr.02/2020 dhe nenit 11 par. 3 të Rregullores, Për Organizmin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës, Nr.01/392.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

GJ.A.nr. 441/2022, Datë: 19.05.2022

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë

Albina Shabani - Rama



Vendimi u dorëzohet:

*Këshillit Gjyqësorë të Kosovës,
Gjyqtarit Latif Xhemajli,
Udhëheqësit të Departamentit Administrativ,
Udhëheqësit të Departamentit të Përgjithshëm,
Administratorit të Gjykatës Themelore në Prishtinë,
Zyrës së Personelit të Gjykatës Themelore në Prishtinë.*



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRIŠTINA – BASIC COURT OF PRISTINA

GJ.A.nr.445/22

KRYETARJA E GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË, Albina Shabani-Rama, në bazë të nenit 32 të Ligjit për Gjykatat (Ligji nr.06/L-054) dhe nenit 11 par. 3 të Rregullores Nr.02/2020, Për Organizmin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës, me datë 19.05.2022, merr këtë:

V E N D I M

- I. Gjyqtari i Gjykatës Themelore në Prishtinë Ramush Bardiqi, **CAKTOHET** nga Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Fiskal në Departamentin Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi nga data 01.06.2022.

A r s y e t i m

Duke marrë parasysh krijimin e Gjykatës Komerciale dhe shuarjen e Divizionit Fiskal, si dhe duke u bazuar në nevojën për plotësim të pozitave vakante për shkak të avancimit të gjyqtarëve të Departamentit Administrativ në Gjykatën e Apelit, Kryetarja e Gjykatës ka vendosur që të sistemoj gjyqtarin Ramush Bardiqi nga Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Fiskal në Departamentin Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe i njëjti të ngarkohet me lëndet e gjyqtarit H.Hoti, i cili tanimë është avancuar në Gjykatën e Apelit.

Ky caktim i gjyqtarit Bardiqi është bazuar në kualifikimet e gjyqtarit të cilat parashihen me nenin 32 të Ligjit për Gjykatat, si dhe për të siguruar një menaxhim dhe gjykim më efikas të lëndëve, sipas nenit 11 par. 3 të Rregullores Nr.02/2020 Për Organizmin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave.


Vendimi është mbështetur në nenin 32 të Ligjit për Gjykata, Nr.02/2020 dhe nenit 11 par. 3 të Rregullores, Për Organizmin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës, Nr.01/392.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

GJ.A.nr. 445/2022, Datë: 19.05.2022

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë

Albina Shabani – Rama



Vendimi u dorëzohet:

*Këshillit Gjyqësorë të Kosovës,
Gjyqtarit Ramush Bardiqi,
Udhëheqësit të Departamentit Administrativ,
Administratorit të Gjykatës Themelore në Prishtinë,
Zyrës së Personelit të Gjykatës Themelore në Prishtinë.*



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRIŠTINA – BASIC COURT OF PRISTINA

GJ.A.nr.440/22

KRYETARJA E GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË, Albina Shabani-Rama, në bazë të nenit 32 të Ligjit për Gjykata (Ligji nr.06/L-054) dhe nenit 11 par. 7 të Rregullores Nr.02/2020, Për Organizmin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës, me datë 19.05.2022, merr këtë:

V E N D I M

- I. Gjyqtari i Gjykatës Themelore në Prishtinë **Adnan Konushevci, CAKTOHET** Udhëheqës i Departamentit të Përgjithshëm dhe Gjyqtar përgjegjës i Divizionit Civil.

- II. Ky vendim hyn në fuqi nga data 01.06.2022.

A r s y e t i m

Pas mbajtjes së kolegjiut me datë 18.05.2022 me gjyqtarët e Departamentit të Përgjithshëm – Divizioni Civil dhe aprovimit njëzëri, duke pas parasysh nevojën për plotësimin e kësaj pozite, Kryetarja e Gjykatës ka vendosur që të caktoj gjyqtarin Adnan Konushevci, **Udhëheqës i Departamentit të Përgjithshëm dhe Gjyqtar përgjegjës i Divizionit Civil**, duke u bazuar në kualifikimet e tij të cilat parashihen me nenin 32 të Ligjit për Gjykatat, si dhe për të siguruar efikasitetin dhe efektivitetin e Departamentit të përgjithshëm, sipas nenit 11 par. 7 të Rregullores Nr.02/2020.

Vendimi është mbështetur në nenin 32 të Ligjit për Gjykatë, Nr.02/2020 dhe nenit 11 par. 7 të Rregullores, Për Organizmin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës, Nr.01/392.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

GJ.A.nr.440/22, Datë: 19.05.2022

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë

Albina Shabani – Rama



Vendimi u dorëzohet:

*Këshillit Gjyqësor të Kosovës,
Gjyqtarit Adnan Konushevi,
Administratorit të Gjykatës Themelore në Prishtinë,
Zyrës së Personelit të Gjykatës Themelore në Prishtinë.*